



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KËSHILLI I BASHKISË**

PROJEKT-VENDIM

Nr. 1, datë 31/01 2022

**MBI MIRATIMIN E KRITEREVE TË DHËNIES SË NDIHMËS EKONOMIKE NGA
FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK - NDIHMËN EKONOMIKE DERI NË 6 % DHE
NGA FONDET E DREJTORISË SË SHËRBIMIT SOCIAL.**

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës 31.01.2022, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 8/2, 9 pika 1.1, gërma “b”, 21, 64 gërma “c”, të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” neni 21, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019, i ndryshuar date 29.12.2021, kreu IV, pika 1, 2 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”. si dhe VKM nr.8 datë 14.01.2015 i ndryshuar në datë 15.01.2019 “Për mbrojtjen e Shtresave në Nevojë, për efekt të heqjes së Fashës së Kompesimit të Energjisë Elektrike deri në 300 kwh në muaj” . VKB nr.94 datë 28.12.2021 “Per miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe PBA përfundimtare 2022-2024”.

V E N D O S I:

- I. Miratimin e kriterëve për dhënie të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 % dhe nga fondet e drejtorisë së shërbimit social si më poshtë:
1. Familje të varfëra të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit.
 2. Familje me kryefamiljare gra në vështirësi ekonomike dhe sociale.
 3. Familje që kanë në përbërje anëtarë mbi moshë pune.
 4. Familje me shumë fëmijë.

5. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtarë që ndjekin arsimin bazë dhe universitar.
 6. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtarë me paaftesi/invalide pune.
 7. Familje që kanë një anëtar dhe janë të braktisur ose të vetmuar.
 8. Familjet të rikthyera nga emigracioni ose azil kërkuese që i përkasin komunitetit rom/egjiptian dhe mazhorancë.
 9. Familje shumë të varfëra që për shkaqe sociale nuk arrijnë të aplikojnë sipas ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019, i ndryshuar date 29.12.2021 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” këto familje do të trajtohen nga fondet e buxhetit vendorë .
- II. Dokumentat e aplikuesve të jenë sipas ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 597 datë 04.09.2019, i ndryshuar date 29.12.2021 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.
- III. Masa e ndihmës ekonomike të llogaritet sipas VKM nr. 597 date 04.09.2019, i ndryshuar date 29.12.2021 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.
- IV. Dokumentat e aplikusve për piken 8 të kriteve janë : Certificate familjare, Fotokopjen e kartës së identitetit, Vërtetim nga Njësia Administrative ose SPZ, dokumenta të ndryshem nga institucionet shëndetësore dhe institucione të tjera vendore ose lokale, verifikime në sistemin e-albania dhe formularin e paraqitjes mujore.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Ervin Ceca



Këshilli i Bashkisë e miratoi me : 18 Vota Pro, — Vota Kundër, — Vota Abstenim



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK**

PROJEKTVENDIM

Nr. 2, datë 31/01 2022

MBI MIRATIMIN E GRANTIN TË MENJËHERSHËM PËR FAMILJEN E Z. TOMOR HOXHA, TRAJTUAR ME BANESË ME KOSTO TË ULËT NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE

Kryetari i Bashkisë ,mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 9, pika 1.2,a, neni 54 germa e, neni 46 “Granti i menjëhershëm për banesat me kosto të ulët “ të Ligjit Nr. 22/2018 , “Për strehimin social ”, V.K.M Nr.555, datë 15.07.2020 ” Proçedurat, kriteret dhe përparësive për akordimin e grantit të menjëhershëm , për banesat me kosto të ulët nga buxheti i shtetit ”

Propozon :

1. Miratimin e grantit të menjëhershëm, për familjen e z.Tomor Hoxha, trajtuar me banesë me kosto të ulët, ndërtuar nga Enti Kombëtar i Banesave.

Nr	Emër Mbiemër	Kontrata e lidhur me EKB	Vlera e shitblerejes sipas kontratës	Shuma e grantit që kërkohet nga buxheti (4*10%)
1	2	3	4	5
1	Tomor Hoxha	Nr.1021 rep, Nr.607 kol,dt 19.05.2017	2 857 502	285 750

2. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi , ngarkohet Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave ,Transportit dhe Shërbimeve .

KRYETARI I KËSHILLIT

Ervin Ceca



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK
PROJEKTVENDIM**

Nr. 3, datë 31/01/2022

**“ MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË BERAT, SË
BASHKU ME DOKUMENTACIONINTEKNIKO- LIGJOR PËR AKORDIMIN E
NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJEN E Z MYSTEAK KUKA
BANESA E TË CILIT ESHTË DËMTUAR NGA TERMETI, NGA BUXHETI I
BASHKISË DHE BUXHETI I VITIT 2022 NË MINISTRINË E MBROJTJES ,
PROGRAMI “ EMERGJENCAT CIVILE “**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” , Ligjin nr. 8756, date 26.03.2001 “ Per Emergjencat Civile “ i ndryshuar dhe VKM nr. 329 date 16.05.2012 “Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shtetore financiare per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerezore “: me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak;

V E N D O S I :

1. Te miratojë kërkesën e Bashkisë Berat për mbështetje financiare të shtetasit Mysteak Kuka per demtimin e baneses nga termeti i rënë në daten 26.11.2019.
2. Te miratoje dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Berat.
3. T'i akordojë si ndihmë emergjente nga buxheti i Bashkise Berat, fondi i emergjencave civile i destinuar dhe i miratuar nga Keshilli i Bashkisë për vitin 2022, familjes së shtetasit
4. Mysteak Kuka ne vleren 80653 (tetedhjetemijeegjashteqindeepesedhjetetree) leke.
5. Ndihma financiare për familjen e shtetasit Mysteak Kuka përcaktohet sipas kriterëve të VKM nr. 329, datë 16.05.2012.
6. Ndihma financiare që do te akordohet do të perdoret per t'i ardhur në ndihmë familjeve të shtetasit Mysteak Kuka banesa e të cilit eshte dëmtuar nga termeti.
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës , Drejtoria Emergjencave Civile Pronave Transportit dhe Sherbimeve.

KRYETARI I KËSHILLIT

Ervin Ceca

5



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK**

PROJEKTVENDIM

Nr. 4, datë 31/01 2022

**PËR SHITESA DHE NDRYSHIME NË VKB NR.36, DATË 22.05.2020 MIRATIMIN E NIVELIT
TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË BASHKISË BERAT DHE TË PUNONJËSVE TË NJËSIVE
NË VARËSI TË SAJ**

Këshilli Bashkiak Berat pasi u njoh me materialin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Berat “ Për një ndryshim në VKB datë 22.05.2020 “Miratimin e Nivelit të Pagave të punonjësve të Bashkisë së Beratit dhe të Njësive Shpenzuese në varësi të saj”, në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen Vendore” neni 64 gërma “ j ”, ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimit Nr. 142 të Këshillit të Ministrave, datë 12.3.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” (e ndryshuar), Vendimit Nr. 165, datë 2.3.2016 të Këshillit të Ministrave “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, VKM 717 date 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore” i ndryshuar, VKB nr.36 datë 22.05.2020 “Miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Berat dhe punonjësve të njësive shpenzuese në varësi të saj”, VKB nr.80 datë 07.12.2021 Riorganizimin e Drejtorisë së Shërbimeve publike, Ndërmarrjes së Gjellbërimit dhe krijimin e Agjencisë së Shërbimeve Publike” VKB nr.87 datë 18.12.2021 “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Berat dhe njësive shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat”, Vendimi I kyetarit të bashkisë nr.860 datë 20.12.2021 “Për miratimin e strukturës dhe organigramës së Bashkisë dhe njësive shpenzuese për vitin 2021. ”VKB Nr . 94 date 29/12/2021 të Keshillit Bashkiak Berat “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2022 dhe PBA 2022-2024” ;

V E N D O S I :

1.Të miratojë ndryshimin e VKB-së nr. 36, datë 22.05.2020 “Miratimin E Nivelit Të Pagave Të Punonjësve Të Bashkisë Së Beratit Dhe Të Punonjësve Të Njësive Në Varësi Të Saj” si më poshtë:

- Në lidhjen nr.1 bëhen disa shtesa sipas lidhjes bashkëlidhur këtij vendimi.

Emërtimi	Kategoria	Paga e Grupit	Shtesa për Vjetërsi në %	Shtesa për Pozicion
Punonjës Rinie	IV-a	1,2 ose 3	2%	38,000

- Lidhja nr.4 dhe lidhje nr.5 ndryshohen sipas lidhjes bashkëlidhur këtij vendimi.

Agjencia e Sherbimeve Publike

Emërtimi	Kategoria	Paga e Grupit	Shtesa për Vjetërsi në %	Shtesa për Pozicion
Drejtor	II-b	I	2%	64,000
Përgjegjës i Sektorit të Financës	III-a/1	I	2%	55,000
SPECIALIST FINANCE	III-b	1 ose 2	2%	42,000
Magaznier	V		1%	34,100
Specialist Jurist, Administrat dhe Protokoll-Arkivi	III-b	1 ose 2	2%	42,000
Përgjegjës i Sektorit të Mirëmbajtjes së Rrugëve, Ndriçimit Publik dhe Dekorit	III-a/1	I	2%	55,000
Specialist për ndriçimin publik	III-b	1 ose 2	2%	42,000
Specialist i Mirëmbajtjes së Rrugëve	IV-a	1,2 ose 3	2%	38,000
Teknik punimesh	VI		1%	34,500
Punëtorë mirëmbajtës	IV		1%	33,400
Punëtorë Asfaltimi	IV		1%	33,400
Elektriciist për ndriçim publik	IV		1%	33,400
Punëtor trotuari, Kalldremxhi	IV		1%	33,400
Përgjegjës i Sektorit të Gjelberimit	III-a/1	I	2%	55,000
Specialist për Gjelbërimin dhe Mjedisin	III-b	1, ose 2	2%	42,000
Specialist për Gjelbërim dekorativ	IV-a	1,2 ose 3	2%	38,000
Mirëmbajtës të Gjelbërimit dekorativ	IV		1%	33,400
Krasitës, Kositës, Trapjantues	II		1%	31,600
Lulishtarë	II		1%	31,600
Punonjës për pastrimin e hapsirave të gjelbëruara	II		1%	31,600
Përgjegjës i Sektorit Mekanik	III-b	1 ose 2	2%	47,000
Shofer transporti mbi 2.5 ton	VIII		1%	35,400
Fadromist dhe Skrepist	VIII		1%	35,400
Fadromist Mekanik	VIII		1%	35,400
Shofer kamioni	VIII		1%	35,400
Shofer Autokulle mbi 2.5 ton	VIII		1%	35,400
Shofer Transporti -2.5 ton	IV		1%	33,400
Manovrator, Rulist dhe Mekanik	IV		1%	33,400

Përgjegjës i Sektorit të Mirëmbajtjes së varrezave publike	III-b	1 ose 2	2%	47,000
Punëtor mirembajtjen e varrezave publike në Njësitë Administrative	IV		1%	33,400
Roje nate për varrezat publike	II		1%	31,600
Punëtor për hapjen e varreve (Varrëmihe)	II		1%	31,600
Sanitare në tregun industrial	I		1%	30,000
Roje nate për Agjensinë e shërbimeve, Tregut Industrial, tregu f. perime	II		1%	31,600

- Në lidhjen nr.6 bëhen disa shtesa sipas lidhjes bashëlidhur këtij vendimi

DREJTORIA ARSIMORE BASHKIA BERAT

Emërtimi	Kategoria	Paga e Grupit	Shtesa për Vjetërsi në %	Shtesa për Pozicion
Specialist arsimit për kopshtet dhe çerdhet	IV-a	1,2 ose 3	2%	38,000

- Miratimin e një shtese për Specialistët IT në vlerën 5000 leke në muaj.
- Efektet financiare të këtij vendimi përballohen nga buxheti i Bashkisë Berat dhe i Njësisë Shpenzuese për vitin 2022.
- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, Drejtoria e Arsimit dhe Agjencia e Shërbimeve Publike.
- Ky vendim hyn në fuqi sipas parashikimeve të pikës 6 të nenit 55, të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe pas konfirmimit nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Berat dhe i shtrin efektet financiare duke filluar nga 01.01.2022.

KRYETARI I KËSHILLIT

Ervin Ceca





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK BERAT

PROJEKTVENDIM
Nr. 5, datë 31/01/2022

PËR NJË SHITESË NË VKB NR.92 DATË 28 / 12 /2021, "MBI MIRATIMIN E BURSAVE PËR NXËNËSIT E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE PËR VITIN SHKOLLOR 2021-2022"

Kryetari i Bashkisë pasi u njoh me materialin e paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, Bashkia Berat, mbështetur në ligjin nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 8, neni 9, neni 64, gërma "c", VKM nr.666, datë 10.10.2019, "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike", i ndryshuar.

VENDOSI :

1. Në VKB nr.92 datë 28.12.2021 "Mbi miratimin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike për vitin shkollor 2021-2022", të shtohet pika 1.2 me këtë përmbajtje:

Miratimin e bursës së plotë për nxënësit :

Nr	Emer Mbiemer	Shkolla	Klasa	Kriteri	Shenime
Kriter invaliditeti (Ish perfitues)					
1	Fatjon Agron Dudushi	Stiliano Bandilli	XIII	Jo ekonomik pika 2.3,d	ish perfitues
2	Orgito Cane Daji	Stiliano Bandilli	XII	Jo ekonomik pika 2.3,d	ish perfitues
3	Iljas Haxhi Xhaxho	Stiliano Bandilli	XII	Jo ekonomik pika 2.3,d	ish perfitues

4	Bujar Andrea Avrami	Stiliano Bandilli	XI	Jo ekonomik pika 2.3,d	ish perfitues
5	Rajmond Artur Cela	Stiliano Bandilli	XII	Jo ekonomik pika 2.3,d	ish perfitues
6	Andrea Adnan Papa	Stiliano Bandilli	XII	Jo ekonomik pika 2.3,d	ish perfitues
7	Sabri Ferdi Dushku	Stiliano Bandilli	XIII	Jo ekonomik pika 2.3,d	ish perfitues
8	Ledion Ysmet Aliaj	Kristo Isak	XII	Jo ekonomik pika 2.3,d	ish perfitues

Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Arsimit e Bashkisë Berat.

K R Y E T A R I K Ë S H I L L I T B A S H K I A K B E R A T

Ervin Ceca

